

Në Qendrën Kulturore të Kosovës në Cyrih festohet 1 Qershori

Të premten, më 1 qershor, Qendra Kulturore e Kosovës në Cyrih gumëzhinte nga zërat e gëzuar të fëmijëve. Ata po festonin ditën e tyre –Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve.

Kjo ditë, e cila u kushtohet fëmijëve në mbarë botën, festohet me aktivitete të larmishme.

Me këtë rast, u dha një shfaqje nga aktorët *Ramadan Morina* dhe *Adem Kica*, shfaqje kjo që krijoi atmosferë argëtuese për më të vegjlit shqiptarë në Zvicër.

Fëmijët ishin shumë të gëzuar. Ata patën rastin të vallëzojnë dhe të këndojnë bashkë me aktorët.

Në këtë ditë pati edhe aktivitete të tjera për fëmijë.



